

**I. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vend pune për personel ndihmësakademik (Laborant) pranë Fakultetit të Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike në Departamentin e Inxhinierisë Fizike.**

**A. Kandidatët për personel ndihmësakademik (Laborant) në Departamentin e Inxhinierisë Fizike, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të kenë përfunduar studimet universitare në sistemin 3+2 (Bachelor dhe Master i Shkencave) apo diplomë të integruar të nivelit të dytë në Fizikë/Inxhinieri Fizike;
2. Të kenë notë mesatare të përgjithshme të ponderuar të studimeve të larta së paku 75/100;
3. Preferohen kandidatët që kanë eksperiencë pune në laborator, fizikë e përgjithshme apo laboratorë shkencorë të institucioneve të arsimit të lartë;
4. Kandidatët të kenë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.

**II. Universiteti Politeknik i Tiranës, shpall 1 (një) vende pune për personel ndihmësakademik pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës në pozicionin “Sekretare Mësimore”.**

**A. Kandidatët për personel ndihmësakademik në pozicionin “Sekretare Mësimore” pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, duhet të plotësojnë kriteret përcaktuese si më poshtë:**

1. Të zotërojnë diplomë të nivelit të dytë “Master i Shkencave”;
2. Të zotërojnë me dëshmi universitare një gjuhë të huaj perëndimore, preferohet anglisht;
3. Të kenë njohuri të mira të programeve bazë kompjuterike;
4. Të kenë aftësi të mira komunikuese dhe kërkuese për realizimin e detyrave;
5. Të mos jenë larguar nga puna për masa disiplinore.
6. Të kenë eksperiencë pune në fusha të ngjashme.

**III. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Letër motivimi;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuara; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MAS);
5. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
6. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
9. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **10.04.2024** pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Juridike në Rektoratit e Universitetit Politeknik të Tiranës, dokumentacionin e sipërcituar.